



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Projekt Vendimi Nr.3
dt.15 .09.2022

Mbi
Dhënien e ndihmës financiare familjeve të dëmtura nga zjarri për vitin
2020 & 2021 & 2022.

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetë qeverisjen vendore” i ndryshuar ,Ligji Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerezore”,Vendimi Nr.414 dt.08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhëtit të shtetit për Mbrojtjen Civile,si dhe në shkresën Nr.1007/1 prot dt.17.06.2022”Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2022”,të AKMC e protokolluar nga ana jonë me shkresën nr.3567 Prot dt.22.06.2022.

Përsa më sipër, Kryetari i Bashkisë Vau - Dejës për të përballuar dëmet e shkaktuara nga zjarri i rënë në banesat e tyre që janë banorë të Bashkisë Vau-Dejës, i propozon Këshillit Bashkiak që me shumicë votash:

V E N D O S I :

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare prej **3.302.158** (tremilion e treqind e dy mije e njëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë për 8 (gjashtë) shtetasit e Bashkisë Vau-Dejës të dëmtuar në 20% te vlerës totale të dëmit për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesat e tyre nga djegia e banesave gjatë viteve 2020, 2021 dhe 2022 si me poshte:

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Adresa	Vlera Totale e Demit	Traj.sipas VKB Nr/ date	Shuma e kaluar Sipas VKB 30%	Shuma e per tu paguar 20% ne leke
1.	Pëllumb	Pjetër	Hila	NJ.A.Bushat	399.862	VKB Nr.13 dt.25.02.2020 konf.shkr.211/1 dt.12.03.2020	120.000	79.972
2.	Gezim	Gjergj	Luka	Nj.Admin.Vau-Dejes	406.540	VKB Nr.14 dt.25.02.2020 konf.shkr.212/1 dt.12.03.2020	122.000	81.308
3.	Ben	Bib	Gjinaj	Nj.Admin.Vig Mnele	1,948,594	VKB Nr.15 dt.25.02.2020 konf.shkr.213/1 dt.12.03.2020	585.000	389.719
4.	Çesk	Pal	Daja	Nj.Admin.Hajmel	1.504.078	VKB nr.17 dt.25.02.2020 konf.shkr.215/1 dt.11.03.2020	450.000	300.816
5.	Gjon	Lek	Markaj	Nj.Admin.Vau-Dejes	269.980	VKB Nr.28 dt.24.04.2020	80.994	53.996

						konf.shkr.312/1 dt.11.05.2020		
6.	Andi	Gjergj	Ndoj	Nj.Admin.Hajmel	626.190	VKB.Nr.27 DT.24.04.2020 Konf.shkr.311/1 dt.11.05.2020	187.857	125.238
7.	Nikolin	Dod	Hiluku	Nj.Admin.Vau-Dejes	6.691.126	VKB Nr.52 dt.26.08.2021 konf.shkr.610/1 dt.10.09.2021	2.007.338	1.338.225
8.	Nikoll	Zef	Pecaj	Nj.Admin.Vig Mnele	4.664.421	VKB Nr.15 dt.28.03.2022 konf.shkr.225/1 dt.14.04.2022	1,399,326	932.884
Shuma								3.302.158

2. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banoreve të dëmtuar.

3. **Burimi i financimit** do të jetë fondi i kushtëzuar i planifikuar në programin “Emergjencat Civile “i cili është miratuar në rishpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile për vitin 2022” që është bërë i disponueshëm në Sistemin Informatik financiar të Qeverisë sipas shkresës Nr.1007/1 prot dt.17.06.2022”Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2022”, të AKMC e protokolluar nga ana jonë me shkresën nr.3567 Prot dt.22.06.2022.

Konfirmoi bazen ligjore

Kristine SHTATRI

Konceptoi

Valjeta NIKAJ

KRYETARI

Mark BABANI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA VAU-DEJES
SEKTORI I FINANCË BUXHET

Vau-Dejes, me 17.09.2022

LISTA E FAMILJEVE TË DËMTUARA NGA ZJARRET GJATË VITEVE 2020 & 2021 & 2022

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Adresa	Nr. Personal ID	Viti i Demtimit	Totali i demit	Shuma e kaluar 30%	Pagesa %	Shuma Leke
1	Pellumb	Pjeter	Hila	Njesia Admins. Bushat	H60305096U	2020	399,862	120,000	20	79,972
2	Gezim	Gjergj	Luka	Njesia Admin. Vau-Dejes	I50503045T	2020	406,540	122,000	20	81,308
3	Ben	Bib	Gjinaj	Njesia Admin Vig Mnele	H60228048V	2020	1,948,594	585,000	20	389,719
4	Çesk	Pal	Daja	Njesia Admins. Hajmel	G41228087R	2020	1,504,078	450,000	20	300,816
5	Gjon	Lek	Markaj	Njesia Admin. Vau-Dejes	I00706034U	2020	269,980	80,994	20	53,996
6	Andi	Gjergj	Ndoj	Njesia Admin. Hajmel	J10721059N	2020	626,190	187,857	20	125,238
7	Nikolin	Dod	Hiluku	Shelqet	G41101101I	2021	6,691,126	2,007,338	20	1,338,225
8	Nikoll	Zef	Pecaj	Mnele e madhe	G10510093V	2022	4,664,421	1,399,326	20	932,884
Totali 8 familje me shumen 3.302.158 leke										3,302,158

Konceptoi

Vajjeta Nikaj




KRYETARI I BASHKISE
Mark BABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE**

Nr. 3/1 Prot.

Vau Dejës, me ___ / ___ 2022

RELACION

**Per miratimin e dhënies ndihmës financiare familjeve të dëmtuara nga zjarri
për vitet 2020, 2021**

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia e re Vau-Dejës ndodhet në Qarkun e Shkodrës dhe shtrihet në pjesën veriore të vendit. Qendra më e madhe e afërt urbane është qyteti i Shkodrës, vetëm 20 km larg; ndërsa largësia nga Tirana, kryeqyteti i vendit është 92 km. Bashkia kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkinë e Shkodrës, në lindje me bashkinë Fushë Arrëz ndërsa në jug me bashkitë Pukë dhe Lezhë. Qendra e Bashkisë është qyteti i **Vaut të Dejës**.

Bazuar në Reformën Territoriale, miratuar me Ligjin nr 115/2014 “Për ndarjen administrativo–territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Bushat, Hajmel, Vig Mnelë, Vau-Dejës, Temal dhe Shllak. Bashkia ka nën administrim 47 fshatra dhe një qytet. Njësia administrative Bushat ka numrin më të lartë të fshatrave (14 fshatra), i cili vijohet nga Temal (10 fshatra). Njësitë administrative Vig Mnelë dhe Hajmel kanë një numër shumë të vogël të fshatrave, respektivisht tre dhe pesë. Të gjitha njësitë janë pjesë e Rrethit Shkodër të Qarkut Shkodër.

Ligji Nr.139/2015 për Vetqeverisjen vendore në nenin 29 thuhet: *Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike Bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e këtyre funksioneve: 1. **Mbrojtjen civile**, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*

VKM nr.329 dt.16.05.2012”Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore pika 1 thuhet: ” *Shteti ndihmon financiarisht të dëmtuarit, në rastet kur , si rezultat i fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore , kanë pësuar dëm në njerëz dhe dëm në materiale në kushtet kur për përballimin e situatës :*

a. Është shpallur gjendja e emergjencave civile

b. Nuk është shpallur gjendja e emergjencave civile

Në Ligjin nr 45/2019 “ Për mbrojtjen civile” ,Neni 65 ,thuhet: *Bashkitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësite, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji mbështeten në parashikimin minimal prej 4% të totalit të buxhetit vjetor të tyre , të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.*

Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burime financiare si: *të ardhurat vendore, nga fondet që ju vijnë drejtperdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare , huamarrja vendore , donacionet, burime te tjera të parashikuar në ligj.*

Procedurat dhe kriteret e ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile miratohen me Vendim të Këshillit Ministrave, që është VKM Nr.414 dt.08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile në pikën 3 thuhet: *“Fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të përdoret sipas prioritizimit sipas pikës 3.1:*

✚ 60-100 % e fondit të detikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret për a: *Akordimin e ndihmës financiare për familjet , banesat e të cilave janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera , sipas kriterëve specifike të përcaktuara në aktet nënligjore që rregullojnë ligjin Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 41.*

Në ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen Civile”, Neni 41 pika 2 thuhet: *“Dëmet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia , nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile” si dhe pika 3 thuhet: “Në rast se bashkitë nuk kanë fonde të mjaftueshme për kompensimin, atëherë i planifikojnë ato për vitet pasardhëse , deri në masën e kompensimit të subjekteve të dëmtuara.*

Gjatë vitit 2020, 2021 dhe 2022 janë djegur 8 objekte banimi për të cilat është zbatuar procedura në zbatim të VKM Nr.329/2012 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” dhe janë trajtuar sipas VKB përkatëse në masën 30% të vlerës totale të dëmit.

Spektori i Emergjencave Civile menjëherë pas trajtimit nga ana e Këshillit Bashkiak në masën 30% të vlerës totale të dëmit i është drejtuar zyrtarisht Agjensisë Kombetare te Mbrojtjes Civile nëpërmjet Prefekturës së Qarkut Shkodër me shkresat përkatëse ku kërkonte dëmshpërblimin e vlerës së mbetur për të gjitha rastet. Theksojmë këtu se keto familje nuk janë trajtuar nga AKMC por në përgjigje të shkresave të tyre thuhet që bazuar ne Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile” nenin 41 “E drejta e kompensimit “ pika 2,3 dhe 4 dëmet e shkaktuara nga fatkeqësite natyrore dhe fatkeqësi të tjera duhet të përballohen nga vetë Bashkitë me fondin e kushtëzuar për “mbrojtjen civile” dhe vetem në rastet kur vlera e kompensimit tejkalon 8% e Buxhetit të Bashkisë ,Komiteti i Mbrojtjes Civile, vëndos që kompensimi të kryhet nga Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

Në këtë projekt vendim 8 familjet e dëmtuara gjatë viteve 2020, 2021 dhe 2022 parashikojmë të trajtohen me 20% të vlerës totale të dëmit .

Bashkengjitur relacionit është edhe tabela e detajuar me të gjitha të dhënat e nevojshme për argumentimin e fakteve që thamë me sipër .

Duke ju falenderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit Nr.3 dt.16.09.2022

Përgjegjësi i Emergjencave Civile


Valjeta **NIKAJ**



KRYETARI I BASHKISË

Mark **BABANI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 414, datë 8.7.2021

P Ë R

**MIRATIMIN E PROCEDURAVE DHE KRITEREVE TË NDARJES
DHE TË PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR
TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN CIVILE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 65, të ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Bashkitë, për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile, të përfitojnë nga buxheti qendror një fond të kushtëzuar për mbrojtjen civile.
2. Kriteret e përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumentet orientuese për përdorimin e këtij fondi, duhet të bazohen në:
 - a) strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë;
 - b) vlerësimin vendor të riskut;
 - c) planin vendor të emergjencave civile;
 - ç) planin e zhvillimit urban.
3. Fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të përdoret sipas prioritizimit, si më poshtë vijon:
 - 3.1. 60 (gjashtëdhjetë) % - 100 (njëqind) % e fondit të dedikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret për:

- a) akordimin e ndihmës financiare për familjet, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera, sipas kriterëve specifike të përcaktuara në aktet nënligjore që rregullojnë ligjin nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, neni 41;
- b) marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objektet infrastrukturore që përbëjnë një kërcënim serioz për jetën e njerëzve, pronat e tyre dhe mjedisin, të cilat ndikojnë në rikthimin e jetës normale për komunitetin e veprimtaritë e tij ekonomike;
- c) shërbime të ndërhyrjes së menjëhershme në shpëtimin e jetës së shtetasve, pronës private e publike, si dhe mbrojtjen e mjedisit, të cilat janë dëmtuar ose kërcënohen nga fatkeqësi të ndryshme;
- ç) ngritjen, përditësimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave;
- d) mirëmbajtjen dhe për funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm të njoftimit dhe alarmit;
- dh) mbajtjen në gatishmëri të sistemeve të mbrojtjes nga zjarri, kalueshmërinë e pandërprerë të rrugëve rurale, vendet e strehimit, si dhe mbledhjen e administrimin e rezervave ushqimore për njerëzit dhe gjënë e gjallë;
- e) mbajtjen në gatishmëri të infrastrukturës së ujitjes, të kullimit, të mbrojtjes nga përmytja dhe digat e rezervuarëve në administrim të tyre;
- ë) shpenzime të kryera për blerje karburanti dhe pjesë ndërrimi për automjete dhe makineri, të cilat përdoren për përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e një fatkeqësie;
- f) mbulimin e shpenzimeve të tjera operative të kryera gjatë përballimit të ngjarjeve dhe situatave të emergjencës civile;
- g) blerje materialesh të ndryshme, që i shërbejnë veprimtarisë së strukturave të emergjencës civile në nivel vendor;
- gj) marrjen e masave mbrojtëse, parandaluese dhe për financimin e objekteve që ndikojnë në rikthimin e jetës normale për komunitetin dhe veprimtaritë e tij ekonomike;
- h) likuidimin e detyrimeve fiskale, taksa portale dhe tatime, të shpenzimeve të transportit dhe akomodimit të forcave, mjeteve të specializuara të vendit dhe të huaja, të pajisjeve dhe makinerive të marra me qira dhe të dhuruara, si dhe për magazinimin e tyre.

3.2. Në rast se do lindë nevoja dhe do të teprojnë fonde nga pika 3.1, fondi i dedikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret deri në masën 30 (tridhjetë) % për:

- a) plotësimin e strukturave operacionale me pajisje dhe trajnime në fushën e mbrojtjes civile;
- b) marrjen me qira të pajisjeve, mjediseve private, mjeteve motorike, mjeteve ajrore dhe makinerive të ndryshme, si dhe për dëmin e shkaktuar nga ekzekutimi i punimeve në pasuritë e paluajtshme të shtetasve në përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e një fatkeqësie, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
- c) organizimin e fushatave të sensibilizimit dhe informimit të komunitetit në fushën e mbrojtjes civile dhe reagimit ndaj fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera;
- ç) përditësimin e strategjisë, dokumentit të vlerësimit të riskut dhe planit të emergjencave civile për reduktimin e riskut nga fatkeqësitë, në nivel vendor dhe planet e evakuimit;
- d) mbështetjen financiare të operacioneve me forca dhe mjete të bashkive të tjera apo të huaja, në raste të fatkeqësive natyrore apo fatkeqësive të tjera.

3.3. Sipas rastit dhe në qoftë se do të teprojnë fonde nga pikat 3.1 dhe 3.2, fondi i dedikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret deri në masën 10 (dhjetë) % për:

- a) aktivizimin e kapaciteteve të subjekteve publike e private brenda territorit administrativ të tyre, për të bashkëpunuar dhe për të asistuar bashkitë fqinje, në rastet kur kjo e fundit është prekur nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi tjetër;
- b) veprimtari të ndryshme që organizojnë strukturat përgjegjëse të mbrojtjes civile, për aktivitetet, trajnimet dhe shërbimet që ndikojnë direkt në forcimin e këtyre strukturave;
- c) botime, për veprimtari kërkimore-shkencore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile dhe aktivitete të tjera në interes të strukturave të mbrojtjes civile.

4. Në rast se konsiderohet e nevojshme të tejkalohej përqindjet e parashikuara nga pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3, ky tejkalim duhet të autorizohet me një vendim të Këshillit Bashkiak.

5. Përdorimi i fondeve, sipas përcaktimeve më sipër, miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak.

6. Prefekti, pas konfirmimit të ligjshmërisë të vendimit të Këshillit Bashkiak, informon Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

7. Bashkitë, 1 (një) herë në 4 (katër) muaj, duhet të raportojnë për përdorimin e fondeve, mënyrën e përdorimit të tyre te Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe te Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
8. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, bashkitë dhe prefektët e qarqeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRÇE


MINISTRI I MBROJTJES

NIKO PELESHI